



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 5205/Prot.
29

Tiranë, më 12.12.2022

URDHËR

Nr. 210 datë 12.12.2022

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Në zbatim të nenit 21, pika 2 të ligjit nr. 10296/2010, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të udhëzimit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të Statutit dhe Rregullores së brendshme,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, sipas dokumentit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Strategjia e Menaxhimit të Riskut monitorohet në vazhdimësi dhe ecuria e implementimit të raportohet në mënyrë periodike.
3. Strategjia e Menaxhimit të Riskut rishikohet dhe përditësohet çdo vit, duke integruar të gjitha ndryshimet dhe pritshmëritë lidhur me arritjen e objektivave për periudhat në vijim.
4. Ngarkohen me ndjekjen dhe monitorimin e implementimit të Strategjisë Drejtorët e Drejtorive, Përgjegjësit e Sektorëve, si dhe me zbatimin e saj të gjithë punonjësit e QSHA-së

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALLIU



Konceptoi: A. Alia; E. Meçaj

Bulevardi "Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

www.qsha.gov.al
Aurora.Balliu@qsha.gov.al

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT DHE PLANI AFAT- GJATË I VEPRIMIT

**PËR
QENDRËN E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

2023

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>I. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT</u>	4
<u>I.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe Planit afatgjatë të veprimit</u>	5
<u>I.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut</u>	5
<u>I.1.3 Vlerësimi i risqeve</u>	5
<u>I.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut</u>	5
<u>I.2 Qasja metodologjike</u>	6
<u>I.3 Përmbajtja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut</u>	6
<u>II RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE</u>	7
<u>II.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional</u> ..	7
<u>II.2 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)</u>	11
<u>II.3 Risqe dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe veprimtarisë së institucionit, me aktor të jashtëm të interesuar dhe publikun</u>	12
<u>III. PLANI I VEPRIMIT</u>	18
<u>III.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit</u>	18

I. Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Plani Afat-gjatë i Veprimit

Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Plani Afat-gjatë i Veprimit për Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) u hartua gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2022. Qëllimi i këtyre dokumenteve është: i) vlerësimi i risqeve të cilat komprometojnë aftësinë e QSHA për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara si dhe ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së institucionit. Këto fusha përfshijnë: i) fusha e menaxhimit financiar; ii) fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) fusha e kontrollit dhe auditimit, iv) fusha e transparencës; v) fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve shkresore si dhe informacionit e të dokumenteve elektronike; vi) fusha e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare; vii) fusha e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara; viii) fusha e menaxhimit të databazave shtetërore; ix) fusha e pajisjes së studentëve të regjistruar në IAL me numra matrikullimi; x) fusha e njohjes së diplomave të arsimit të lartë dhe atij parauniversitar, të përfunduar jashtë vendit; xi) fusha e pajisjes së IAL-ve me regjistra; xii) fusha e regjistrimit të formave të diplomave; xiii) fusha e legalizimit të dokumenteve të lëshuara nga institucionet e arsimit parauniversitar; xiv) etj.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, metodë sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e QSHA-së, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive. Strategjia e Menaxhimit të Riskut është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Strategjia gjithashtu i referohet përgjegjësiave dhe objektivave të vendosura në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Parauniversitar dhe Strategjitë e Arsimit të Lartë dhe atij Parauniversitar. QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, të pranimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit. QSHA-ja konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së QSHA-së e integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës dhe nuk duhet parë si një program i shkëputur. Në vijim, menaxhimi i riskut duhet të bëhet përgjegjësi e çdo punonjësi në QSHA, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese. Strategjia e Menaxhimit të Riskut fokusohet në risqet e nivelit operacional.

Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen institucioni i QSHA-së.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në QSHA jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e institucionit. Ajo synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

I.I Strategjia e Menaxhimit të Riskut

Procesi i hartimit të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në QSHA konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

I.I.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe Planit Afat-gjatë të Veprimit dhe mobilizimi i stafit të QSHA-së bazuar në urdhrin nr. 190, datë 11.11.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të grupit të auditit të MAS”. Në përbërje të grupit të punës ishin punonjës të QSHA të nivelit drejtues (drejtor drejtorie, përgjegjës sektori).

I.I.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës u fokusua në analizën e kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përfshiu dhe analizën e raporteve të ndryshme të QSHA mbi veprimtarinë e saj, por edhe të jashtme mbi çështje që lidhen me fushat e veprimtarisë së institucionit. Grupi i punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të QSHA. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të grupeve të fokusuara me punonjësit e drejtorive përbërëse.

Grupi i Punës u fokusuar me stafin e QSHA-së, për të matur perceptimet e tyre mbi çështje të integritetit dhe etikës në institucion, si edhe për të vlerësuar njohuritë e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural për integritetin në institucion.

I.I.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

Gjatë kësaj faze, grupi i punës vlerësoi intensitetin e risqeve të analizuar në fazën e mësipërme. Grupi i punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritët të mbështesin ose rrisin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan gjithashtu diskutimet dhe feedback-u i marrë nga fokus grupet me stafin e drejtorive të drejtorisë së përgjithshme.

I.I.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë

aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afateve kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

I.2 Qasja metodologjike

Për procesin e vlerësimit të riskut, u përdor metoda cilësore: Përmes zhvillimit të takimeve orientuese për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit me grupin e punës. Takimet e fokusuara shërbyen për të identifikuar proceset e punës në fusha të veprimtarisë së institucionit të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjelljeve jo etike e joprofesionale dhe parregullsive të tjera, si dhe për të vlerësuar risqet e integritetit dhe faktorët e tyre në kuadër të këtyre proceseve. Procesi u shoqërua edhe me një analizë të kuadrit të brendshëm rregullator të QSHA-së, konkretisht: rregullore, urdhra, akte emërimi apo akte të brendshme. Gjithashtu, janë marrë në shqyrtim raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e QSHA-së, të tilla si: raporte të auditit të brendshëm, raporte monitorimi, raporte vjetore, etj.

I.3 Përmbajtja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut

Përmbajtja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe paraqitet si më poshtë:

- **Prezantimi i përgjithshëm i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të QSHA.**
- **Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre-** i cili përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në fushat e përgjegjësisë së institucionit.
- **Plani i Veprimit,** i cili përmban masat e kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuar dhe të vlerësuara.

Plani i është vënë në dispozicion të gjithë stafit të QSHA-së, për të qenë një dokument i gjallë dhe një instrument efektiv që orienton punët e përditshme drejt interesit publik, standardeve të larta profesionale dhe performancës së mirë institucionale.

QSHA-ja nëpërmjet kësaj Strategjie, angazhohet të sigurojë që rreziqet identifikohen dhe trajtohen në kohën e duhur. Parimet e mëposhtme të Politikës së Menaxhimit të Riskut në QSHA pranohen të përdoren si orientime për politikën e brendshme të menaxhimit të riskut.

Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut është:

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot shoqërore dhe financiare në minimumin e domosdoshëm.

Përmbushja e qëllimeve të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut realizohet nëpërmjet:

- a. Ngritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të QSHA-së, lidhur më çështjet e menaxhimit të riskut.

- b. Përkufizimit të fushave të riskut dhe të detyrave delikate në veprimtarinë e QSHA-së.
- c. Monitorimit të qëndrueshëm të fushave të riskut.
- d. Ndërmarrjes së masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

Parimet e Menaxhimit të Riskut:

Strategjia është ndërtuar mbështetur në disa parime thelbësore që përcaktojnë dhe qëndrimin e institucionit të QSHA-së ndaj menaxhimit të riskut, të cilat janë si vijon:

- Menaxhimi i Riskut krijon dhe mbron vlerat;
- Menaxhimi i Riskut është pjesë integrale e detyrave të institucionit;
- Menaxhimi i Riskut është pjesë e vendimmarrjes;
- Menaxhimi i Riskut i adresohet pasigurisë;
- Menaxhimi i Riskut është sistematik, i strukturuar dhe në kohë;
- Menaxhimi i Riskut bazohet në informacionin më të saktë të mundshëm;
- Menaxhimi i Riskut merr në konsideratë faktorët njerëzor dhe kulturor;
- Menaxhimi i Riskut është transparent dhe përfshirës;
- Menaxhimi i Riskut është dinamik, interaktiv dhe reagues ndaj ndryshimeve;
- Menaxhimi i Riskut lehtëson përmirësimin e vazhdueshëm të institucionit.

II. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE

Në këtë seksion është paraqitur një përshkrim i përmblendhur i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të analizuara sipas fushave të veprimtarisë dhe misionit të QSHA-së.

Ecuria e procesit të menaxhimit të riskut:

QSHA-ja ka vendosur objektiva të qarta për periudhën njëvjeçare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo i kushtëzon QSHA-së identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Menaxhimi i riskut është një prej elementëve të ciklit të planifikimit dhe të marrjes së vendimeve. Për këtë kërkohet vendosja dhe zotërimi i një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të rrezikut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet QSHA-ja.

Risku karakterizon çdo veprimtari që kryen njeriu në shoqëri, ekonomi, politikë, arsim shkencë, shëndetësi, rend, turizëm, infrastrukturë, etj. Çdo risk është specifik d.m.th. ka natyrën e tij, përmasat, densitetin (i lartë, i mesëm, i ulët), ndikimin, masën e humbjeve, (dëmtimeve), etj. Risku në sistem përcaktohet nga natyra e proceseve, objekteve dhe struktura (infrastruktura

Risku është pasiguria e rezultatit, dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon :

- Të rritet besimin në arritjen e rezultateve të dëshiruara
- Të trajtohen kërcënimet në mënyrë efektive në nivele të pranueshme;
- Të merren vendime të informuara mbi shfrytëzimin e mundësive.

Menaxhimi i riskut konceptohet si tërësia e proceseve të përfshira në identifikimin, vlerësimin dhe gjykimin e risqeve, përcaktimin e përgjegjësisë, ndërmarrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parashikimin e tyre, si dhe monitorimin dhe rishikimin e progresit.

QSHA-ja e konsideron Menaxhimin e Riskut si balancim të një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët nëse kërkohet që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duhet të jenë në ekuilibër me njëri tjetrin. Analiza e riskut është një proces i vazhdueshëm. Gjithashtu kufizimi i riskut duhet të bëhet nëpërmjet marrjes në kohën e duhur të masave të përshtatshme korrigjuese dhe riparuese.

Detyrimet që lidhen me realizimin e politikës së menaxhimit të riskut janë:

1. Detyrim i drejtorëve të drejtorive është monitorimi dhe verifikimi periodik i risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave të drejtorive të tyre.
2. Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin e riskut dhe për vlerësimin e tij.
3. Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
4. Çdo veprim i punonjësit i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të vlerësohet dhe sipas gjykimit të mbështetet nga drejtuesit.
5. Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.

Me qëllim garantimin e realizimit të politikës së menaxhimit të riskut, vendoset procedura kuadër e menaxhimit të riskut.

PROCEDURA KUADËR E MENAXHIMIT TË RISKUT:

- a) hartimi i Planit Vjetor të Punës,
- b) evidentimi i fushave themelore të funksionimit,
- c) identifikimi i zonave të riskut në kuadër të fushave të veprimit të përcaktuara,
- d) përkufizimi dhe përshkrimi i këtyre risqeve,
- e) vlerësimi i impaktit të një risku të caktuar,
- f) përkufizimi i probabilitetit që një risk i caktuar të ndodhë,
- g) përgjigja ndaj riskut, masa parandaluese, duke përfshirë ato që tashmë janë zbatuar dhe ato që janë të domosdoshme në të ardhmen (të planifikuara),
- h) caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës të caktuar,
- i) përgatitja e hartës/regjistrimit të riskut,
- j) monitorimi dhe raportimi.

Komponentët e Menaxhimit të Riskut Institucional:

Menaxhimi riskut institucional përbëhet nga pesë komponentë të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, të ndërthurur ndërmjet njeri tjetrit. Ata rrjedhin nga mënyra se si menaxhimi drejton dhe se si këto elemente janë të integruar me procesin e menaxhimit.

Këta pesë komponentë janë:

1. Mjedisi i kontrollit;
 2. Menaxhimi i riskut;
 3. Aktivitetet e kontrollit
 4. Informimi dhe komunikimi
 5. Monitorimi
- Mjedisi i kontrollit përshkruan kulturën e riskut në QSHA që tregon se si çështja e riskut shikohet dhe adresohet në këtë institucion. Ajo përfshin filozofinë e menaxhimit të riskut, integritetin dhe vlerat etike dhe profesionale si dhe strukturën organizative, stilin e punës së drejtuesve, politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore.
 - Vendosja e objektivave: Pa përcaktuar objektivat është e pamundur të identifikohen ngjarjet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave. Menaxhimi Riskut institucional siguron që ka një proces të ndërtuar për vendosjen e objektivave në linjë me misionin e detyrat e institucionit dhe në pajtueshmëri me nivelin e riskut.
 - Identifikimi i ngjarjeve: duke identifikuar ngjarjet e jashtme dhe të brendshme që influencojnë në realizimin e objektivave bëhet e mundur që të përcaktohen mundësitë dhe

kërcënimet. Mundësitë më pas kthehen në Strategji dhe objektiva të vendosura prej menaxhimit.

- Vlerësimi i Riskut. Risqet analizohen duke konsideruar gjasat dhe impaktin, si një bazë për të vendosur se si ato do të menaxhohen në vijim.
- Përgjigja ndaj riskut. Kur risqet ndodhin, ka një tërësi mundësisht për të reaguar. Risku mund të shmangët, zvogëlohet, pranohet apo dhe transferohet/kalohet në përgjegjësinë e një pronari tjetër të riskut.

Në zbatimin e komponentëve të Menaxhimit të Riskut, QSHA ka në konsideratë qëllimin e përgjithshëm të veprimtarisë në të gjitha nivelet e institucionit, strategjitë e miratuara nga Ministria e Arsimit që lidhen me veprimtarinë e saj. Gjithashtu janë marrë në konsideratë dhe iniciativat dhe projektet e së ardhmes. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” janë përcaktuar detyrat, sa më poshtë:

- a) Vlerëson dhe menaxhon arritjet e nxënësve, nëpërmjet zhvillimit të provimeve kombëtare dhe vlerësimit të jashtëm, me kampionim.
- b) Kontribuon në hartimin e politikave të vlerësimit dhe të strategjive të zbatimit të tyre.
- c) Analizon dhe interpreton, sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të grupeve të interesit, rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve dhe i përpunon ato për publikim.
- ç) Harton të dhënat shkollore dhe të maturës shkollore për pranimin e studentëve në shkollat e larta të vendit.
- d) Përpunon të dhënat për provimet përfundimtare të mësuesve për shkallët e karrierës.
- dh) Kontribuon në hartimin e rregulloreve të provimeve kombëtare dhe të pranimeve.
- e) Krijon një sistem unik dhe transparent për përcaktimin e kandidatëve fitues në programet e studimit, sipas parimit meritë - preferencë.
- ë) Analizon të dhënat e procesit dhe realizon studime për përmirësimin e sistemit të pranimeve në arsimin e lartë publik dhe organizimin e provimit të shtetit.
- f) Menaxhon, implementon dhe mbikëqyr procesin kompleks që nga testimi i njohurive teorike e praktike të mësuesve dhe të profesioneve të tjera, si gjatë periudhës së testimit, ashtu edhe gjatë ushtrimit të profesionit e të mbikëqyrjes.
- g) Digjitalizon testet e hartuara nga Komisioni i Provimit të Shtetit dhe përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë për zhvillimin e provimit të shtetit, përmes teknologjisë digjitale.
- gj) Trajnon personelin organizues dhe mbikëqyrës të provimit të shtetit dhe publikon online programin orientues të këtij provimi.
- h) Bën shpalljen e rezultateve të provimit të shtetit;
- i) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet për procesin e pranimin të maturantëve në shkollat e larta dhe për organizimin e provimit të shtetit.

Hapi i parë lidhet me hartimin e planit vjetor të punës, i cili duhet të përfshijë të gjitha detyrat që i ngarkohen QSHA-së nga legjislacioni në fuqi, si dhe rekomandimet dhe detyrat e dala pas kontrolleve të ndryshme. Detyrat e përcaktuara në planin e punës duhet të jenë të përgjithshme

në masën e duhur, si dhe të përmbajnë qëllime të qarta dhe të lexueshme (sasiore, tregues dhe kuota), si dhe të përmbajnë afatin e realizimit të tyre. Evidentimi i fushave kryesore të funksionimit të QSHA-së, bëhet mbështetur në “hartën e proceseve të realizuara, i cili përkufizon dhe përshkruan detyrat reale të saj.

II.I Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional

Nga analiza e kuadrit të brendshëm rregullator, rezulton se QSHA-ja ka Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Në rregullore gjejmë parashikime sa i takon deklarimit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesave, detyrimin për të informuar paraprakisht eprorin për veprimtaritë me pagesë që kryen jashtë detyrës publike, detyrimin për të kryer veprimtari të tilla vetëm me lejen me shkrim të institucionit, detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar nga subjektet private, me përjashtim të kategorisë së informacionit i cili për arsyet e parashikuara në ligj nuk mund të publikohet, përfshirjen e njëjësive/funksioneve të cilat rrjedhin nga ligje të tjera.

Megjithatë, nga analiza e kuadrit të brendshëm rregullator, rezulton se ka rregulla për procesin e deklarimit dhe pranimit të dhuratave, administrimit të regjistrimit përkatës apo përfitime të tjera të ngjashme, rregulla për pranimin e donacioneve/dhurimeve dhe rregulla për menaxhimin e regjistrimit përkatës, standarde të sjelljes së punonjësve pas mbarimit të detyrës, rregulla të brendshme për deklarimin e pasurisë për funksionarët që janë subjekt deklarimi.

Parashikime lidhur me rregullat e etikës për nëpunësit e QSHA-së i gjejmë në rregulloren e institucionit, të tilla si rregulla lidhur me sjelljen e nëpunësit gjatë orarit të kryerjes së detyrës, si dhe pas saj, komunikimin me eprorët, kolegët dhe vartësit, ruajtja e konfidencialitetit për informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrës.

II.2 Risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)

QSHA ka një organikë të miratuar me 44 punonjës. Nga analiza e vendeve vakante rezulton se ka mungesë në staf në pozicione të ndryshme. Largimet e shpeshta të punonjësve kanë bërë që vendet vakante të mbushen me të rinj, të cilët kanë nevojë për të fituar eksperiencën e nevojshme për të realizuar me sukses detyrën, sipas pozicioneve përkatëse dhe përshkrimit të vendit të punës.

Një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të burimeve njerëzore është trajnimi i vazhdueshëm i tyre.

Në QSHA është ngritur autoriteti përgjegjës për deklarimin, regjistrimin dhe monitorimin e rasteve të konfliktit të interesit.

Nëpërmjet këtij dokumenti kemi për qëllim të përmirësojmë politikat, rregullat dhe praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Ky përmban:

- a. vlerësimin e risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e QSHA-së për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.
- b. përcaktimi i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara.
- c. formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

II.3 Risqe dhe faktorët e risqeve

Identifikimi i zonave të riskut në kontekstin e fushës së veprimit të QSHA-së konsiston në përcaktimin e risqeve, mbështetur në ndarjen e risqeve:

- 1) risqe të brendshme dhe risqe të jashtme;
- 2) risqet në nivel subjekti dhe në nivel detyrash.

"Risk" është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë". Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut janë të lidhura ngushtë me realizimin e qëllimeve të QSHA-së.

Me qëllim që të menaxhohet risku, QSHA-ja ka identifikuar risqet me të cilat ajo mund të përballet dhe i ka vlerësuar ato. Identifikimi i risqeve është hapi i parë në krijimin e profilit të riskut të QSHA-së dhe dokumentimi i tij është konsideruar i një rëndësie kritike për menaxhimin efektiv të riskut.

QSHA-ja ka përdorur identifikimin e vazhdueshëm të riskut i cili është i nevojshëm për të identifikuar risqe të reja që nuk kanë dalë më parë, ndryshimet në risqet ekzistuese ose risqe ekzistenca e të cilave nuk është më e përshtatshme për të. Në çdo rast, risqet janë konsideruar të lidhura ngushtë me objektivat, janë adresuar dhe prioritarizuar në lidhje me to sipas nivelit përkatës, nga niveli më i ulët teknik deri tek objektivat strategjike. Në këtë aspekt janë identifikuar ngjarjet nëse mund të ndodhin dhe ndikimi që do të kenë nëse ndodhin dhe në këtë identifikim janë marrë në konsideratë një gamë e gjerë e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët mund të shtojnë mundësinë e risqeve apo dhe mundësive, në kontekstin e plotë të qëllimit të veprimtarisë së QSHA-së.

Risqet dhe faktorët e risqeve janë grupuar në dy kategoritë kryesore: faktorë të jashtëm dhe faktorë të brendshëm: Faktorët e jashtëm përfshijnë, por nuk kufizohen në faktorë që vijnë nga ndryshimet në kuadrin ligjor që lidhen me veprimtaritë e institucionit apo ndryshimet teknologjike si dhe veprimtari që lidhen me institucione të tjera. Faktorët e brendshëm rrjedhin nga mënyra e menaxhimit dhe përfshijnë strukturën, kompetencat, aftësitë si dhe mënyrën se si funksionojnë sistemet e informacionit. Risqe të parashikuara për realizimin e objektivave janë risku i brendshëm për formalizimin e procedurave për menaxhimin e riskut dhe risku i jashtëm për sigurimin e burimeve të ndryshme të financimit për arritjen e objektivave. QSHA-ja administron të dhëna shtetërore që lidhen me Sistemit Elektronik të Vlerësimit të Maturës Shtetërore, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në IAL dhe Sistemin e Provimeve të Shtetit. Nevojiten të merren të gjitha masat

e duhura për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre sistemeve si nga faktorë të brendshëm ashtu edhe nga faktorë të jashtëm. Rregullorja e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale përmban të gjitha rregullat që duhen zbatuar për ruajtjen e këtyre sistemeve. Risku lidhet me risqet e brendshme dhe të jashtme që softet të mos funksionojnë, prandaj regjistri i riskut duhet të përcaktojë me detaje raste të tilla.

VLERËSIMI I RISKUT:

Në vlerësimin e risqeve QSHA-ja është udhëhequr nga tre parimet bazë:

- Siguria se ka një proces të strukturuar qartë në të cilin si mundësia edhe impakti, konsiderohen, për secilin risk;
- Regjistrimi i vlerësimit të riskut në një mënyrë që lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioriteteve të riskut;
- Qartësimi mbi ndryshimin ndërmjet riskut të qenësishëm dhe riskut të mbetur;

Ky moment kyç përfshin procesin e identifikimit të risqeve të njohura gjerësisht, por edhe të risqeve të reja. Analiza ka për qëllim përshkrimin e riskut kaq mirë, saqë të jetë i mundur vlerësimi i tij si dhe përzgjedhja e veprimeve të duhura. Risqet mund të klasifikohen në këndvështrimin e objekteve (ngjarjeve), por edhe të subjekteve (grupet e personave). Mund të dallojmë disa faktorë të riskut, që kanë ndikim në rezultatin e analizës, psh. numri i punonjësve të subjektit dhe kualifikimet e tyre, çështje të etikës së sjelljes së punonjësve, ndryshimet në mënyrën e veprimit, ndryshimi i strukturës organizative, lëvizja e personelit, ndryshimet e sistemeve informatike, rezultatet dhe koha që ka kaluar nga kontrolli i kryer më përpara mbi njësinë, apo auditimi i saj, kushtet e punës etj.

Në mënyrë që identifikimi i riskut të jetë objektiv, i thelluar dhe në një perspektivë afat-gjatë, të karakterizohet nga marrja sistematike dhe me një logjikë të caktuar e masave të ndryshme, duhet të respektohen parimet e mëposhtme:

- 1) identifikimi i riskut duhet të kryhet nga një ekip pune i posaçëm,
- 2) puna për këtë detyrë duhet të zhvillohet sistematikisht dhe me plan,
- 3) prioritet duhet të konsiderohen kriteret bazë (p.sh. arritja e qëllimeve më të rëndësishme të subjektit),
- 4) identifikimi i riskut duhet të kryhet në lidhje të ngushtë me zonat e riskut.

Duhet të merren gjithashtu parasysh faktorët, që e favorizojnë lindjen e një risku të caktuar, si p.sh: dështimet në arritjen e qëllimeve në të kaluarën; mosrealizimi i detyrës, ose qëllimit, parregullsi në të shkuarën, shpenzime të parregullta, cenimi i procedurave, shkelja e ligjit, ose e rregulloreve të brendshme.

Metodologjia e ndjekur:

Si pjesë e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, QSHA-ja përpilon Regjistrin e Riskut. Në përcaktimin e risqeve angazhohen të gjithë punonjësit e QSHA-së, duke filluar nga specialistët dhe deri tek drejtorët e drejtorive dhe drejtori i përgjithshëm. Këto risqe diskutohen në nivel drejtorie dhe pastaj pasqyrohen në regjistrin e riskut. Së pari rrënjët e riskut duhet të kërkohen

tek veprimtaria njerëzore. Risku duhet të parashikohet, vlerësohet dhe duhet të merren masa për zvogëlimin e tij. Vlerësimi i riskut është një proces shumë i vështirë që kushtëzohet nga shumë faktorë.

Faktorët e Riskut:

Vlerësimi i riskut është një proces i vështirë që kushtëzohet nga shumë faktorë. Faktorët shqyrtohen në shumë nivele, përfshirë këtu subjektin njerëzit (sjelljen), proceset e kontabilitetit dhe të veprimtarisë, kontrollet ose sistemet e kompjuterizuara. Më poshtë po përmendim disa prej faktorëve të riskut që lidhen me veprimtarinë e institucionit:

Faktorët e brendshëm që lidhen me nevojën për trajnime të punonjësve të QSHA-së apo me kontrollet e vazhdueshme që duhet të bëhen për të siguruar funksionimin e softeve si dhe funksionimin e pajisjeve për shumëfishimin e tetëve dhe me faktorët e jashtëm që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me kompanitë e mirëmbajtjes së sistemeve apo realizimin e testeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, ku përfshihen edhe institucione të tjera përveç QSHA-së në këtë proces.

Bazuar në objektivat strategjike të QSHA-së dhe risqet që pengojnë përmbushjen e këtyre objektiveve, produkti final është hartimi i Regjistrit të Riskut, të paraqitura sipas shkallës së mundësisë së ndodhjes dhe pasojave të riskut. Rezultatet e regjistrit të përgjithshëm të riskut janë pasqyruar në Regjistrin e Riskut të QSHA-së. Të gjitha risqet e identifikuar janë klasifikuar si risqe të brendshëm ose të jashtëm dhe për secilin risk është specifikuar dhe pronari/zotëruesi i tij, d.m.th. personi përgjegjës për menaxhimin e riskut. Kur kontrollet ekzistuese janë konsideruar si të papërshtatshme për të sjellë riskun në nivelin e oreksit për risk, atëherë janë identifikuar masa shtesë me qëllim zbutjen e riskut. Pasi vlerësohen risqet, përcaktohen prioritetet e riskut.

Risku i korrupsionit: Integriteti është një parakusht për performancën efektive dhe të vazhdueshme për realizimin e detyrave të QSHA-së. Qytetarët duhet të kenë besim tek puna e institucionit, dhe kjo e vendos QSHA-në para përgjegjësive shtesë për ndërtimin e figurës së pastër dhe me integritet të specialistëve të saj.

Risku në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore:

Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit janë miratuar Statusi dhe Rregullorja e brendshme e QSHA-së të cilat përcaktojnë procedurat e monitorimit të pajtueshmërisë së punonjësve me legjislacionin për etikën personale dhe profesionale. Risku në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore lidhet me strukturën organizative të njësisë e cila është në përputhje me objektivat, stilin e punës së drejtuesve dhe politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore.

Risku i mbrojtjes dhe ruajtjes së databazave të të dhënave shtetërore:

QSHA-ja administron të dhëna shtetërore që lidhen me Sistemin Elektronik të Vlerësimit të Maturës Shtetërore, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar, Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në IAL dhe Sistemin e Provimeve të Shtetit. Nevojiten të merren të gjitha masat e duhura për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre sistemeve si nga faktorë të brendshëm ashtu edhe nga faktorë të jashtëm. Rregullorja e brendshme për mbrojtjen,

përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale përmban të gjitha rregullat që duhen zbatuar për ruajtjen e këtyre sistemeve.

Në përfundim të identifikimit dhe më pas vlerësimit të riskut kryhet dokumentimi i cili bëhet në një mënyrë të tillë e cila regjistron fazat e procesit. Dokumentimi i vlerësimit të riskut krijon një profil risku për QSHA-në, i cili lehtëson identifikimin e prioriteteve të riskut, kupton arsyet për vendimet e marra rreth asaj se çfarë është apo nuk është ekspozim i tolerueshëm, lehtëson regjistrimin e mënyrës në të cilën është vendosur për t'u trajtuar risku, lejon të gjithë ata të përfshirë në menaxhimin e riskut të shohin profilin e plotë të riskut dhe zonat e tyre të përgjegjësisë, lehtëson rishikimin dhe monitorimin e riskut. Sa me pak i pranueshëm të jetë ekspozimi në lidhje me një risk, aq më i madh është prioriteti i cili duhet t'i jepet për ta adresuar atë. Risqeve me prioritet më të lartë (risqet kyç) duhet t'u jepet vëmendje e vazhdueshme në nivelin më të lartë të menaxhimit dhe për pasojë duhet të merren në konsideratë vazhdimisht nga menaxhimi. Prioritetet e veçanta ndryshojnë me kalimin e kohës mbasi risqet e veçanta trajtohen dhe prioritetet ndryshojnë.

ADRESIMI/TRAJTIMI I RISQEVE:

Qëllimi i adresimit të riskut është për ta kthyer pasigurinë në përfitim të QSHA-së, duke mbajtur nën kontroll kërcënimet dhe duke përfituar nga mundësitë. Çdo veprim i ndërmarrë për të adresuar/trajtuar riskun formon atë që njihet si "kontroll i brendshëm". Këto veprime mund të ndërmerren për të menaxhuar si impaktin nëse risku ka ndodhur ose frekuencën e ndodhjes së riskut.

Duke analizuar impaktin e një risku të caktuar, duhet të kemi parasysh se ky proces ka karakter vlerësimi subjektiv të kryer nga QSHA-ja. Përcaktimi i impaktit të një risku të dhënë duhet të mbështetet në shkallën e mëposhtme të impaktit: I lartë: zgjidhja e problemit do të kërkojë shumë kohë/burime. Shmangja e pasojave do të jetë shumë e vështirë, ndoshta e pamundur. Ai do të ketë ndikimi thelbësor mbi QSHA-në dhe do të përbëjë një ngjarje të rëndësishme publike. Mesatar: zgjidhja e problemit do të kërkojë një kohë/burime mesatare. Shmangja e pasojave do të kërkojë kohë. Mund të ndodhë që të bëhet ngjarje publike. I ulët: zgjidhja e problemit do të kërkojë kohë, por problemi nuk do të shkaktojë dëme të përhershme. Nuk do të bëhet ngjarje publike.

Duke përshkruar si masat e marra tashmë, ashtu edhe ato të planifikuara, me karakter riparues, duhet mbështetur në dokumentet dhe në rregulloret e brendshme të QSHA-së që janë të miratuara, si dhe urdhrat e titullarit, porositë me shkrim që i janë drejtuar stafit të punës, por edhe tek masat e realizuara faktikisht që janë marrë deri më tani në segmente të ndryshme të punës së institucionit. Nëse analiza e kryer tregon se masat e marra deri më tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedura dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët probabiliteti.

Por gjithashtu duhet mbajtur mend se përgjigja ndaj riskut mund të marrë forma të ndryshme:

1. **Tolerimi/pranimi.** Në disa raste ekspozimi ndaj riskut mund të jetë i pranueshëm për QSHA-në dhe si të tilla nuk parashikohet të ndërmerret ndonjë veprim të mëtejshëm. Përgjithësisht janë risqe të cilat kanë mundësi të ulët për të ndodhur dhe njëkohësisht kanë pak gjasa të ndikojnë në arritjen e objektivave të punës së QSHA-së edhe nëse ndodhin. Por vlerësohen dhe raste të veçanta (veçanërisht të risqeve të jashtme) për të cilat aftësia për të reaguar apo përgjigjur për disa risqe mund të jetë e kufizuar ose kosto e ndërmarrjes së ndonjë veprimi mund të jetë jo e favorshme me përfitimin e mundshëm. Në këto raste përgjigja apo reagimi mund të jetë pranimi i nivelit ekzistues të riskut.
2. **Trajtimi/reagimi vendosja e kontrolleve.** Ky është reagimi tipik që synon dhe vetë Strategjia e Menaxhimit të Riskut për QSHA-në. Qëllimi i trajtimit të risqeve është procesi i vazhdueshëm i identifikimit dhe vlerësimit të riskut por njëkohësisht dhe reagimi/përgjigja ndaj tij duke ndërmarrë aktivitetet, masat e nevojshme të kontrolleve për të mbajtur riskun në një nivel të pranueshëm.
3. **Transferimi:** Për disa risqe përgjigja/reagimi më i mirë është jetë transferimi i tyre. Ky opsion është veçanërisht i mirë për të zbutur risqet financiare ose risqet e asetëve. Transferimi i riskut mund të konsiderohet, si për të zvogëluar ekspozimin e QSHA-së por njëkohësisht dhe për rritur efektivitetin e menaxhimit të risqeve. Megjithatë dhe nëse kjo është zgjedhur si përgjigje ndaj riskut, QSHA-ja ka si detyrë që marrëdhënia me palën e tretë së cilës i është transferuar risku të menaxhohet me kujdes për të siguruar transferimin e suksesshëm të riskut (rastet e kryerjes së veprimtarive që QSHA-ja ua jep/prokuron apo bashkëpunon me të tretët).

QSHA-ja ka publikuar në faqen e saj zyrtare Programin e Transparencës, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga analiza e programit, rezulton se janë të publikuara informacione që lidhen me funksionet dhe detyrat e QSHA, procedura që ndjekin punonjësit e QSHA për të marrë vendime, procedura dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë lidhur me veprimet dhe mosveprimet e QSHA, kuadri i plotë rregullator i veprimtarisë së institucionit, të tilla si ligje, VKM, urdhra, udhëzime, rregullore e brendshme, informacion lidhur me të drejtën për t’u informuar dhe ankuar, shoqëruar me formularët përkatës të kërkesës për informacion dhe formate ankesash, informacion lidhur me koordinatorin e të drejtës për informim, informacion lidhur me shërbimet që ofrohen nga QSHA, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar sipas parashikimeve ligjore.

Gjithashtu, pozitive mund të vlerësohet publikimi i informacionit lidhur me mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi QSHA, të tilla si raporte mbi përgatitjen e planit vjetor.

Të dhënat dhe kontakti i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit janë publikuar në Programin e Transparencës së institucionit. Caktimi i koordinuarit ka bërë që ky proces të ketë vëmendjen dhe qëndrueshmërinë e duhur në funksion të përmirësimit të transparencës.

Koordinatori në veprimtarinë e tij të përditshme koordinon punën me të gjitha drejtoritë e QSHA-së, për të bërë të mundur trajtimin në kohë dhe pa vonesa të kërkesave për informacion nga subjektet private, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni në fuqi parashikon zgjatjen e afatit për trajtimin e kërkesave komplekse apo që kërkojnë bashkëpunimin apo konsultimin e disa institucioneve.

Kategoria e informacionit të prezantuar në programin e transparencës i shërben rritjes së llogaridhënies dhe transparencës institucionale në përgjithësi dhe të çdo nëpunësi, si hallkë e zinxhirit të punës në ofrimin e shërbimit në dobi dhe interes të publikut. Nga analiza e morisë së informacionit të publikuar në programin e transparencës të QSHA, rezulton se Programi i Transparencës përmbush kërkesat e ligjit për të drejtën e informimit, në të cilin parashikohet se autoriteti publik duhet të garantojë njohjen maksimale me informacionin publik dhe të mundësojë vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohen kërkesat individuale për informacion.

Koordinatori për të drejtën për informim

Kërkesat e depozituara në kuadër të së drejtës së informimit trajtohen në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Në zbatim të nenit 6, të ligjit 119/2014, të sipërcituar, në faqen zyrtare të QSHA-së është publikuar programi i transparencës për autoritetin QSHA dhe në zbatim të nenit 5, janë bërë përditësimet e kërkuara për programin. Gjithashtu programi përditësohet rast pas rasti për çdo informacion të shtuar nga QSHA.

QSHA në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre, mban regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

III. PLANI I VEPRIMIT PËR RISQET E LARTA

Plani i veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së QSHA. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit, si më poshtë:

1. Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit të QSHA-së, në mënyrë që të minimizohet cenimi i tyre nga risqet e integritetit.
2. Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit.
3. Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së QSHA, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.

III.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit për risqet që cilësohen më të lartat

Monitorimi është periodik dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve apo grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit, për risqet që vlerësohen më të lartat. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetive të risqeve, si dhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga GMS. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Veprimtaritë e kontrollit janë politika dhe procedura që ndihmojnë për realizimin e përgjigjes ndaj risqeve. Veprimtaritë e kontrollit kryhen në të gjithë QSHA-në dhe për të gjitha nivelet dhe funksionet, por në këtë Strategji kontrolli i referohen vetëm kontekstit të menaxhimit të riskut. Për qëllime të menaxhimit të riskut procedurat e kontrollit janë një element shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave. Ato nuk duhet të vendosen formalisht por konsiderohen si mekanizëm për të menaxhuar vetë arritjen e objektivave.

Caktimi i detyrave konkrete lidhur me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës konkretë të QSHA-së

Caktimi i detyrave konkrete duhet të bëhet sipas një qëllimi dhe logjike të caktuar, në lidhje me planin vjetor të punës si dhe rregulloret dhe udhëzimet e brendshme që rregullojnë fushën e veprimit të strukturave të ndryshme organizative dhe të punonjësve të tyre. Duhet të udhëhiqemi gjithashtu nga parimi i evitimit të shkrirjes së përgjegjësive nëpërmjet ngarkimit të një detyre, një grupi tepër të madh punonjësish.

Për shkak të shumëllojshmërisë të risqeve , dhe reagimi ndaj tyre përfshin një numër të konsiderueshëm procedurash apo kontrollesh si përgjigje ndaj tyre, por Standardet përcaktojnë si më të zakonshmen trajtimin e riskut nëpërmjet kontrolleve/procedurave të mëposhtme:

- A. **Kontrollet Parandaluese** - Kontrolle parandaluese të krijuara për të minimizuar mundësinë e riskut që po ndodh (si ndarja e detyrave) Këto kontrolle kufizojnë mundësinë e një rezultati të padëshiruar. Kontrollet parandaluese përfshijnë ndarjen e detyrave, kufizimi i veprimeve të personave të autorizuar (psh, vetëm ata që janë trajnuar dhe autorizuar lejohen të kryejnë veprimtari të caktuara). Kjo lidhet sidomos me aksesin në databazat e të dhënave shtetërore që duhet të hyjnë vetëm personat e autorizuar nga titullari dhe të merren të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Synimi i tyre është parandalimi i ndodhjes së riskut përkatës dhe rritja e sigurisë se objektivat do të arrihen. Zbatimi i Rregullores së brendshme të QSHA-së, Urdhrat dhe Udhëzimet e MAS janë kontrolle që QSHA-ja ka ndërmarrë për të reaguar ndaj risqeve të vlerësuara dhe kanë karakter para veprues/para faktit.
- B. **Kontrollet Korrigjuese** - Kontrolle korrigjuese të krijuara për të korrigjuar rezultatet e padëshirueshme. Ato sigurojnë një rrugëdaljeje për të arritur njëfarë rikuperimi kundrejt humbjes apo dëmtimit. Këto lloj kontrollesh janë parashikuar të zbatohen për të siguruar zbatimin e detyrimeve, është formë korrigjuese pasi lehtëson rikuperimin financiar kundrejt një risku që ka ndodhur.
- C. **Kontrollet Direktive** - Kontrolle drejtuese të krijuara për të siguruar se një rezultat i veçantë është arritur (si masat e sigurisë për ruajtjen e sistemeve). Këto kontrolle sigurojnë arritjen e një rezultati të veçantë tepër specifik siç janë rregullat e sigurisë dhe janë të lidhura ngushtë me objektiva të pajtueshmërisë.
- D. **Kontrollet Zbuluese** -Kontrolle zbuluese të krijuar për të identifikuar kur rezultate të padëshiruara kanë ndodhur (si kontrollet e magazinës apo aktiveve, ose procesi i rakordimit). Këto kontrolle vendosen për të identifikuar rezultatet e padëshiruara pasi ngjarja ka ndodhur (pra risku është bërë efektiv). Në dallim nga kontrollet parandaluese, efekti i tyre është «pas ngjarjes» dhe kanë si qëllim krijimin e një efekti parandalues për të ardhmen Shembuj të kontrolleve zbuluese përfshijnë kontrollin/ inventarizimin periodik të materialeve ose aktiveve (ku zbulohen transaksione të paautorizuara), «rishikime pas zbatimit» nga të cilat “nxirren mësimë” për të ardhmen gjatë aplikimeve për aktivitete të reja dhe monitorimi i aktiviteteve, ku zbulohen ndryshimet të cilat kërkojnë zgjidhje. Kryerja e inventarizimeve sipas përcaktimeve të Standardeve të Kontabilitetit dhe raportimit Financiar, Rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë kontrolle që QSHA-ja zbaton nën këtë kategori kontrollesh.

Mbështetur në sa më sipër QSHA-ja ka adoptuar dhe ndjekur politika dhe procedura që adresojnë risqet kryesore si me poshtë:

Risqet e keqpërdorimit të aseteve:

Siguria fizike: kjo është një masë parandaluese e cila kontrollon dhe monitoron vlerësimin e aseteve, të dokumentacionit ose të sistemeve IT për të garantuar se nuk ka një përdorim të paautorizuar, dëmtim apo humbje informacioni.

Organizimi: organizimi përfshin alokimin e përgjegjësisë ndaj individëve dhe grupeve në mënyrë që ato të punojnë së bashku për të arritur objektivat në mënyrën më eficiente të mundshme. Parimet kryesore të organizimit që kanë të bëjnë me mashtrimin janë:

- Një përcaktim i qartë i përgjegjësisë të individëve për burimet, aktivitetet, objektivat dhe qëllimet. Kjo përfshin përcaktimin e niveleve të autoritetit. Kjo është një masë parandaluese e cila përcakton limitin e përgjegjësisë të cilat mund të autorizohen nga individë zyrtarë.
- Krijimin e linjave të qarta të raportimit dhe hapësirat efektive të ushtrimit të autoritetit për të lejuar mbikëqyrjen adekuate;
- Ndarja e detyrave për të shmangur konfliktin e interesave ose mundësitë për abuzime. Kjo është gjithashtu një masë parandaluese që garanton se çelësi i funksioneve dhe kontrolleve mbi një proces nuk kryhet nga një anëtar i vetëm i stafit.

Mbikëqyrja dhe kontrolli i rezultateve: mbikëqyrja është funksioni nëpërmjet të cilit drejtorët e drejtorive shqyrtojnë punën dhe performancën e stafit të tyre. Mbikëqyrja siguron një kontroll që tregon se stafi po punon, për të përmbushur standardet në përputhje me udhëzimet. Këto shërbejnë si masa parandaluese dhe zbuluese të cilat përfshijnë monitorimin dhe metodat e punës së rezultateve të punës së stafit.

Gjurma e Auditimit: ky është një kontroll i gjerë zbulues, megjithëse prezenca e tij mund të ketë një efekt sigures dhe si rrjedhojë mund të parandalojë mashtrimin.

Procedura e sinjalizimit: - Çdo punonjës, i cili gjatë kryerjes së punës apo në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, vëren fakte, të cilat lënë vend për mundësi të ekzistencës së parregullsive dhe mashtrimeve, informon menjëherë me shkrim eprorin e drejtpërdrejtë ose eprorin e një niveli më të lartë, apo, nëse ai e sheh të dobishme, njofton nëpunësin autorizues ose titullarin e njësisë publike ose direkt nëpunësin e parë autorizues apo njësinë e antikorrupsionit.

Monitorimi: informacioni menaxhues duhet të përfshijë masa dhe tregues të performancës në lidhje me efikasitetin, efektivitetin, ekonominë dhe cilësinë e shërbimit. Monitorimi efektiv, duke përfshirë kontrollet rastësore, duhet të frenojë dhe të zbulojë disa lloje të aktivitetit mashtrues.

Vlerësimi: politikat dhe aktivitetet, duhet të vlerësohen periodikisht për ekonomikitetin, eficientësinë dhe efektivitetin. Menaxhimi i funksionimit mund të kryejë vlerësime, por ato janë zakonisht më efektive kur kryhen nga një grup i pavarur. Vlerësime të tilla mund të zbulojnë mashtrimin.

Stafi: stafi i përshtatshëm është themelor për një sistem për të funksionuar efektivisht. Dobësitë në staf mund të anulojnë efektin në kontrolle të tjera. Postet që përfshijnë kontrollet e veçanta të aseteve me vlerë të madhe, mund të kenë nevojën e një aplikimi të procedurave shtesë

verifikuese. Rotacioni i stafit midis posteve që mbajnë mund të parandalojë ose të zbulojë marrëveshjet e fshehta ose mashtrimin.

Kontrollet Buxhetore dhe kontrolle të tjera financiare: përdorimi i buxheteve dhe limiteve të deleguara për disa kategori shpenzimesh dhe kontrolle të tjera të kontabilitetit duhet të sigurojë se shpenzimet janë aprovuar saktë dhe kontabilizuar saktë nga menaxheri përgjegjës. Kjo duhet të kufizojë qëllimin për mashtrim dhe mund të rezultojë në disa lloje mashtrimesh që mund të zbulohen.

Sistemet e zhvillimit: kontrollet mbi zhvillimin e sistemeve të reja dhe modifikimet ndaj sistemeve ekzistuese ose procedurave, janë thelbësore për të siguruar se efektet e ndryshimit vlerësohen në fazë të hershme dhe përpara implementimit. Risqet e mashtrimit duhet të identifikohen si një pjesë e këtij procesi dhe duhet të paraqiten, përmirësimet e nevojshme në kontroll.

Krijimi i regjistrit të riskut:

Hartimi i një diagrami që grupon risqe të ndryshme sipas impaktit të tyre, në raport me probabilitetin që ato të ndodhin (pra të regjistrit të riskut) është metoda më e thjeshtë, që tregon në formë grafike, ato fusha të veprimtarisë së QSHA-së, për të cilat duhet të tregojë vëmendje të veçantë drejtoria përkatëse e subjektit. Harta e risqeve përftohet sipas modelit të mëposhtëm: Harta e riskut përcakton zonat e riskut, me peshë dhe impakt të ndryshëm.

Mund të veçohen 9 zona të tilla:

- I. zona me prioritet absolut, që kërkon kontrollin permanent të QSHA-së,
- II. zonë me rëndësi të madhe, që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme,
- III. zonë me rëndësi të madhe, por ka pak të ngjarë të ndodhë – kontrolli ciklik,
- IV. zonë me rëndësi të madhe që kërkon kontroll të vazhdueshëm nga ana e nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,
- V. zonë me rëndësi, që kërkon mbikëqyrje ciklike të nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,
- VI. zonë potencialisht e rëndësishme, por me pak probabilitet që të ndodhë,
- VII. zonë kërcënimesh jo shumë të rëndësishme, që kërkon monitorimin në nivel punonjësish,
- VIII. zonë kërcënimesh pak të rëndësishme që kërkon vetëm mbikëqyrje sporadike dhe raportim në periudha kohore të distancuar nga njëra-tjetra.
- IX. zonë kërcënimesh thuajse të parëndësishme.

RISHIKIMI DHE RAPORTIMI I RISQEVE:

Menaxhimi i riskut rishikohet dhe raportohet për dy arsye:

- Për të monitoruar nëse profili i riskut ka ndryshuar;
- Për t'u siguruar që menaxhimi i riskut është efektiv dhe për të identifikuar se kur është i nevojshëm veprim i mëtejshëm.

Proceset rishikuese kryen për të parë nëse risku ekziston akoma, nëse risku është rritur, nëse ndikimi i riskut ka ndryshuar, përmbajtja e raportit ka ndryshuar në përputhje me prioritetet dhe është arritur siguria në efektivitetin e kontrollit. Në vijim, procesi i përgjithshëm i

menaxhimit të riskut është subjekt i rishikimeve të rregullta periodike dhe si i tillë nuk duhet të bëhet por dhe jo të kufizohet në rishikime të paktën një herë në vit. Ky afat i përcaktimit të rishikimit dhe monitorimit të riskut në QSHA ka si qëllim që të sigurohet se menaxhimi i riskut mbetet i përshtatshëm dhe efektiv. Rishikimi i riskut dhe rishikimi procesit të menaxhimit të riskut janë të pavarura dhe nuk zëvendësojnë njëri tjetrin.

QSHA synon të kryejë rishikim të tilla që duhet të:

- Sigurojnë që të gjitha proceset e menaxhimit të riskut janë rishikuar të paktën një herë në vit
- Sigurojnë që risqet në vetvete janë subjekt i rishikimit sipas një frekuence të përshtatshme (me parashikimin e përshtatshëm si për rishikimin e vetë menaxhimit dhe për rishikime të jashtme të riskut).
- Bëjnë parashikime për të informuar rreth risqeve të reja apo ndryshimet në risqet e identifikuar tashmë me qëllim që ndryshimi të adresohet/trajtohet në mënyrë të përshtatshme.

Për të ndihmuar procesin e rishikimit kryhet Vetëvlerësimi i Riskut – sipas së cilës të gjithë strukturat e brendshme të QSHA-së angazhohen të vlerësojnë dhe rishikojnë situatën e ekzistencës dhe vlerësimin të risqeve. Gjithashtu ato vlerësojnë dhe efektivitetin e kontroleve të vendosura si përgjigje ndaj risqeve. Rezultatet e vetëvlerësimit raportohen për të administruar profilin e gjerë të riskut të QSHA-së.

Raportimi i Drejtuesve – që është pjesë e vetëvlerësimit, por nëpërmjet saj Drejtorët janë përgjegjës të rishikojnë dhe raportojnë në mënyrë periodike mbi ecurinë e procesit të menaxhimit të riskut dhe për punën që ata kanë bërë për të mbajtur të përditësuar procedurat e riskut dhe të kontrollit dhe të përshtatshme me kushtet dhe brenda fushave të veçanta të përgjegjësisë.

Kuadri vlerësues i menaxhimit të riskut” i cili siguron një mjet për vlerësimin e nivelit të maturisë së menaxhimit të riskut të QSHA-së dhe parashikohet të përdoret në mënyrë efektive për përgatitjen e deklaratës vjetore mbi kontrollin e brendshëm, si një detyrim që rrjedh nga Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

II.2.6. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI:

Informimi:

Menaxhimi i riskut institucional kërkon veçanërisht që QSHA-ja të zotërojë një gamë të gjerë informacioni të nevojshëm për arritjen e objektivave se sa thjesht informacioni i përditshëm.

Menaxhimi i riskut përfshin informacion që i përket tre periudhave kohore :

1. Të dhënave historike, të cilat lejojnë që të ndjekim performancën aktuale kundrejt objektivave, planeve dhe pritshmërisë dhe na japin njoftime/indikacione të hershme mbi ngjarjet e mundshme që kërkojnë t’u kushtohet vëmendje.
2. Të dhënave aktuale që lejojnë një pamje në kohë reale të risqeve ekzistuese brenda gjithë institucionit dhe për çdo strukturë dhe identifikojnë ndryshimet apo devijimet nga pritshmëritë;

3. Të dhënat për të ardhmen/tendencat të cilat ndihmojnë për të identifikuar dhe vlerësuar risqet e mundshme dhe impaktin e tyre për një periudhë të ardhshme por që janë të lidhura ngushtë me dy grupet e mësipërme të të dhënave

Më qëllim që të arrihet realizimi i suksesshëm dhe me efektivitet i politikës së menaxhimit të riskut është e rëndësishme që çdo individ dhe strukturë e përfshirë në implementimin e Strategjisë së Riskut të ketë informacion të mjaftueshëm për secilën nga këto kategori. I gjithë stafi duhet të njihet me mesazhin që Strategjia e Menaxhimit të Riskut përçon dhe njëkohësisht çdo individ duhet të njohë dhe të dijë rolin që i takon në këtë Strategji. Menaxhimi efektiv i riskut kërkon që personat të njihen me informacionin e duhur, në kohën dhe vendin e duhur.

Komunikimi: Komunikimi dhe informimi nuk është një fazë e veçantë në menaxhimin e riskut, ato ecin përmes të gjithë procesit të menaxhimit të riskut. Komunikimi është i qenësishëm për sistemet e informacionit. Nëpërmjet tij sigurohet që të merret informacioni i duhur nga personat e duhur por QSHA-ja e konsideron komunikimin në një kuptim më të gjerë që përfshin shpërndarjen e kulturës së përbashkët dhe qëndrimit ndaj riskut, që lidhet me pritshmëritë dhe përgjegjësitë e çdo individ apo strukture për këtë çështje. Komunikimi rreth proceseve dhe procedurave duhet të jetë në përshtatje me kulturën që QSHA synon të kultivojë dhe për të arritur qëllimet e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut:

Është e rëndësishme të sigurohet që çdo punonjës në QSHA e kupton çfarë është strategjia e riskut, cilat janë prioritetet e riskut si dhe përgjegjësitë e tyre në përshtatje me këtë kuadër. Nëse kjo nuk arrihet, nuk do të arrihet as futja e përshtatshme dhe e qëndrueshme e menaxhimit të riskut dhe prioritetet e riskut nuk do të mund të adresohen/trajtohen në mënyrë të qëndrueshme.

Është e nevojshme që të kuptohet që shkëmbimi eksperiencave sigurohet nëpërmjet komunikimit dhe ato të përshtatshmet dhe mund të përfitojnë prej tyre. Psh. Nëse për një risk të ri krijohet një kontroll efektiv lidhur me të, kjo eksperiencë duhet t'i komunikohet të gjithë të tjerëve të cilët mund të përballen gjithashtu me këtë risk. Duhet të sigurohemi që çdo nivel i menaxhimit përfshirë dhe vendimmarrja, kërkon dhe merr siguri të përshtatshme dhe të rregullt mbi menaxhimin e risqeve brenda hapësirës së tyre të drejtimit të kontrollit. Ata duhet të sigurohen me informacion të mjaftueshëm që të mund t'i lejojë ata për të planifikuar veprime në përputhje me risqet ku risku i mbetur nuk është i pranueshëm, po ashtu dhe siguri rreth risqeve të cilat mendohet të jenë në mënyrë të pranueshme nën kontroll.

Lidhur me informimin dhe komunikimin, rregulloret e brendshme përcaktojnë komunikimin brenda QSHA-së. Punonjësit janë të informuar si dhe ku t'i raportojnë parregullsitë/problemet. Gjithashtu duhet të sigurohet një komunikim i rregullt me institucionet e tjera jashtë institucionit. Duhet të sigurohet një sistem informacioni që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të QSHA-së.

Regjistri Riskut është pjesë e paketës së diskutimeve gjatë hartimit të planeve vjetore të QSHA-së, pasi menaxhimi i riskut i ka fillesat që në procesin e buxhetimit, siguron lidhjen e buxhetit me realizimin e objektivave dhe matjen e performancës së aktiviteteve gjatë procesit të kontrollit për realizimin e tyre. Në vazhdimësi është i nevojshëm procesi i identifikimit të risqeve të reja dhe ndryshimi e përparësive dhe metodologjive zbutëse të risqeve të identifikuar.

III. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË

Menaxhimi i riskut institucional zbatohet dhe vihet në funksionim nga i gjithë stafi i QSHA-së, drejtues dhe specialistë dhe për rrjedhojë ndikon ndjeshëm në veprimtarinë e çdo individ. Çdo individ karakterizohet nga kompetenca aftësi dhe botëkuptim të ndryshëm dhe kuadri i Menaxhimit të riskut u ofron çdo punonjësi të QSHA-së mekanizmat për tu aftësuar që të kuptojnë risqet në kontekstin e objektivave që kanë ata brenda funksionit dhe Drejtorisë dhe QSHA-së në tërësi. Çdo anëtar i stafit duhet të njohë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij. Kjo siguron dhe lidhjen e nevojshme midis detyrave që ka çdo individ dhe mënyrës se si i kryejnë këto detyra.

Është e rëndësishme që **Regjistri i Riskut** për QSHA-në, të shikohet si hapi i parë në zbatimin e menaxhimit të riskut dhe jo si produkti final. Regjistri i riskut duhet të shikohet si një dokument i cili duhet të rishikohet, të përditësohet dhe zhvillohet së paku njëherë në vit nga sektori, drejtori dhe në tërësi si Institucion.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm. Ky dokument u shpërndahet të gjitha Sektorëve dhe Drejtorive dhe, e shoqëruar kjo me kërkesën e llogaridhënies gjatë procesit të kontrollit të risqeve.

Plan afat-gjatë veprimi për risqet e larta: Realizimi i misionit të Drejtorisë së Vlerësimit

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Risk i jashtëm që sistemi i maturës shtetërore të mos funksionojë	I jashtëm	I lartë	Krijimi i backup-eve periodike Bashkëpunimi me kompaninë dhe AKSHI-n për mirëmbajtjen e sistemit	Sektori i Administrimit të Provimeve Drejtoria e Vlerësimit
2	Risk i brendshëm që softi i MSH të mos funksionojë si duhet .	I brendshëm	I lartë	Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të sistemit. Përcaktimi i sakte i të drejtave të userave në sistem. Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të pajisjeve ndërlidhëse. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së Sistemit dhe AKSHI-n. Trajnime te vazhdueshme te stafit.	Sektori i Administrimit të Provimeve Drejtoria e Vlerësimit
3	Mosfunksionimi i linjës shumëfishuese per testet e PKAB/VANAF/Vlerësime ndërkombëtare	I brendshëm dhe i jashtëm	I lartë	Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të pajisjeve. Mbajtja ne gjendje te mire teknike e makinerive shumëfishuese Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së pajisjeve	Sektori i Administrimit të Provimeve Drejtoria e Vlerësimit
4	Risk i brendshëm që fondi i pyetjeve te MSH, PKAB dhe VANAF të dëmtohet	I brendshëm	I lartë	Krijimi i backup-eve periodike. Update-imi i paswordeve sipas politikave të përcaktuara. Ruajtja e backup-eve të fondeve në vende të sigurta.	Sektori i Provimeve dhe Vlerësimeve Kombëtare/Ndërkombëtare Drejtoria e Vlerësimit

5	Risk i brendshëm që të dëmtohet baza e të dhënave të maturanëve/kandidatëve pjesëmarrës në provimet e maturës.	I brendshëm	I lartë	Verifikim dhe kontroll i të dhënave të kandidatëve me data bazën e QSHA-së, komunikim shkresor me ZVA-të, DRAP-et, DPAP.	Spektori i Administrimit të Provimeve Drejtoria e Vlerësimit
6	Risk i brendshëm që persona të paautorizuar të futen në sistemin e maturës duke thyer fjalëkalimet e tij.	I brendshëm	I lartë	Siguria e brendshme e sistemit të provimit të maturës nëpërmjet fjalëkalimeve të veçanta të sigurisë.	Spektori i Administrimit të Provimeve Drejtoria e Vlerësimit

**Plan afat-gjatë veprimi për risqet e larta:
Realizimi i misionit të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit**

Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
Risk i jashtëm që sistemi i provimit të shtetit të mos funksionojë për shkak të sulmeve të jashtme natyrore ose kibernetike.	I jashtëm	I lartë	Krijimi i backup-eve periodike. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit dhe AKSHI-n për mirëmbajtjen e sistemit dhe zbatimin e protokolleve të sigurisë.	Sektori i Administrimit të Provimeve të shtetit Drejtoria e Provimeve të Shtetit
Risk i brendshëm që sistemi i provimit të shtetit të mos funksionojë.	I brendshëm	I lartë	Testime të vazhdueshme përpara çdo sezoni të provimit të shtetit për sigurimin e mirë funksionimit të sistemit. Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të rrjetit dhe pajisjeve hardware të lidhura në rrjet për të siguruar funksionimin normal të sistemit. Kontrolli i funksionimit të rrjetit të kamerave të sigurisë në ambientet e provimit. Komunikim zyrtar me operatorin e shpërndarjes së energjisë OSHEE, për të siguruar vazhdimësi të energjisë elektrike. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit dhe AKSHI-n. Trajnime të vazhdueshme të stafit.	Sektori i Administrimit të Provimeve të shtetit Drejtoria e Provimeve të Shtetit
Risk i brendshëm që persona të paautorizuar të futen në sistemin e provimit të shtetit duke thyer fjalëkalimet e tij.	I brendshëm	I lartë	Siguria e brendshme e sistemit të provimit të shtetit nëpërmjet fjalëkalimeve të veçanta të sigurisë për çdo modul të sistemit. Monitorimi i modulit të regjistrimit të auditit për çdo veprim në sistem.	Sektori i Administrimit të Provimeve të shtetit Drejtoria e Provimeve të Shtetit

Risk i brendshëm që të dëmtohet sistemi i provimit të shtetit Ky dëmtim mund të shkaktohet nga goditjet e energjisë elektrike, shkaqe natyrore, dëmtimi fizik nga persona keqdashës etj.	I brendshëm	I lartë	Siguria fizike dhe teknike e sistemit të provimit të shtetit dhe ambienteve të provimit. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit dhe AKSHI-n për zbatimin e protokolleve të sigurisë. Masa sigurie për të drejtat e aksesit në ambientet e provimit të shtetit.	Sektori i Administrimit të Provimeve të shtetit Drejtoria e Provimeve të Shtetit
Risk i brendshëm që fondet e pyetjeve të provimit të shtetit dhe provimeve të digjitalizuara të dëmtohen.	I brendshëm dhe i jashtëm	I lartë	Krijimi i backup-eve periodike pas çdo ndryshimi, të fondeve të pyetjeve për të siguruar ruajtjen dhe saktësinë e bazës së të dhënave të fondeve të pyetjeve.	Sektori i Menaxhimit të Fondit të Pyetjeve Drejtoria e Provimeve të Shtetit
Risk i brendshëm që të dëmtohet baza e të dhënave të kandidatëve pjesëmarrës në provimet e shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara.	I brendshëm	I lartë	Verifikim dhe kontroll i të dhënave të kandidatëve me data bazën e QSHA-së, komunikim shkresor me Urdhrat Profesionalë, DPAP dhe Universitetet.	Sektori i Administrimit të Provimeve të shtetit Drejtoria e Provimeve të Shtetit

**Plan afat-gjatë veprimi për risqet e larta:
Realizimi i misionit të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit**

Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
Risk i jashtëm që sistemi i matrikullimit të mos funksionojë.	I jashtëm	I lartë	Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të pajisjeve HW dhe kontrolle paraprake të dhënave dhe funksionimit të softit aktual. Përmirësimi i sistemit aktual dhe implementimi i një sistemi të ri të teknologjisë së informacionit -implementimi i sistemit të përmirësuar në sekretariatë mësimore të IAL-ve -trajnimi i specialisteve të teknologjisë së informacionit pranë IAL-ve	Sektori i Regjistrimit të Studentëve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i jashtëm që Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Arsimor/ SMIP të mos funksionojë.	I jashtëm	I lartë	Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të softit. Përcaktimi i saktë i të drejtave të userave në sistem. Kontrolle paraprake dhe të vazhdueshme të pajisjeve ndërlidhëse. Krijimi i mundësisë për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit. Trajnime të vazhdueshme të stafit IT. Kontrolli dhe mirëmbajtja e pajisjeve HW. Përmirësimi i sistemit, ndërfaqja e përdoruesit -backup i databazë.	Sektori i Regjistrimit të Nxënësve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore

Risk i jashtëm që Sistemi i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë të mos funksionojë.	I jashtëm	I lartë	Komunikime me AKSHI për zgjidhjen e problematikave teknike	Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i brendshëm që persona të paautorizuar të futen në sistemin e matrikullimit duke thyer fjalëkalimet e tij.	I brendshëm	I lartë	Siguria e brendshme e sistemit të matrikullimit nëpërmjet fjalëkalimeve të veçanta të sigurisë.	Sektori i Regjistrimit të Studentëve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i brendshëm që të dëmtohet sistemi i provimit të matrikullimit. Ky dëmtim mund të shkaktohet nga goditjet e energjisë elektrike, shkaqe natyrore, dëmtimi fizik nga persona keqdashës etj.	I brendshëm	I lartë	Siguria fizike dhe teknike e sistemit të matrikullimit dhe ambienteve të provimit. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit dhe AKSHI-n për zbatimin e protokolleve të sigurisë.	Sektori i Regjistrimit të Studentëve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i jashtëm që persona të paautorizuar të futen në sistemin e matrikullimit duke thyer fjalëkalimet e tij.	I brendshëm dhe i jashtëm	I lartë	Siguria e sistemit nëpërmjet fjalëkalimeve të veçanta të sigurisë.	Sektori i Regjistrimit të Nxënësve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i brendshëm që të dëmtohet sistemi i provimit të matrikullimit. Ky dëmtim mund të shkaktohet nga goditjet e energjisë elektrike, shkaqe natyrore, dëmtimi fizik nga persona keqdashës etj.	I brendshëm dhe i jashtëm	I lartë	Siguria fizike dhe teknike e sistemit. Bashkëpunimi me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit dhe AKSHI-n për zbatimin e protokolleve të sigurisë.	Sektori i Regjistrimit të Nxënësve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Risk i brendshëm që të dëmtohet baza e të dhënave të studentëve	I brendshëm	I lartë	Verifikim dhe kontroll i të dhënave të studentëve me data bazën e QSHA-së, komunikim shkresor me IAL-të.	Sektori i Regjistrimit të Studentëve Drejtoria e Shërbimeve Arsimore